“Shkurtimin e mustaqeve, prerjen e thonjve, shkuljen e qimeve të sqetullave dhe rruarjen e qimeve në vendet e turpshme, na është caktuar të mos i vonojmë më shumë se dyzet net

Enes ibn Maliku (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: “Shkurtimin e mustaqeve, prerjen e thonjve, shkuljen e qimeve të sqetullave dhe rruarjen e qimeve në vendet e turpshme, na është caktuar të mos i vonojmë më shumë se dyzet net."
[Sahih] [Transmeton Muslimi]

Profeti përcaktoi se shkurtimi i mustaqeve të burrit, prerja e thonjve të duarve dhe këmbëve, heqja/shkulja e qimeve të sqetullave dhe rruajtja e qimeve të pjesëve të turpshme nuk duhet të lihen pas dore për më shumë se dyzet ditë.

http://sunnah.global/hadeeth/sq/show/66049